



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.11.2021, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit trejavor të punës së komisionit 15 nëntor – 3 dhjetor 2021, si dhe i programit të punës 15 nëntor – 24 dhjetor 2021.

2. “Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 99/2021 “Për ratifikimin e vendimit të komitetit të përbashkët EFTA-Shqipëri nr. 1 i vitit 2021, miratuar më 24.06.2021, për ndryshimin e protokollit B të marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet shteteve të EFTA-s dhe Republikës së Shqipërisë lidhur me përkufizimin e konceptit të “produkteve origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ dhe ndryshimi i marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës dhe Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Islandës si pjesë përbërëse e saj”.

3. Projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës lidhur me vendosjen e kufizimeve të importit të kategorive të materialeve arkeologjike dhe etnologjike të Shqipërisë”.

4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për ripranimin e personave dhe protokollit zbatues të marrëveshjes”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Tomor Alizoti, Etjen Xhafaj, Blendi Klosi, Petro Koçi, Besion Ajazi, Vangjel Dule, Bardhyl Kollçaku, Kreshnik Çollaku, Tritan Shehu, Hatixhe Konomi, Klodiana Spahiu, Lavdrim Krrashi dhe Shpëtim Idrizi.

Mungojnë:

Alqi Bllako, Grida Duma, Benet Beci, Belind Këlliçi dhe Greta Bardeli.

Të ftuar:

Arjana Dyrmishi – Drejtoreshë e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik në MFE

Vjosana Neziri – Drejtor i Drejtorisë Juridike Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD)

Ilia Bili – Drejtor i Drejtorisë së Antikontrabandës në DPD

Flutura Shehi – Përgjegjëse e Sektorit të Origjinës në Drejtorinë e Tarifës dhe Origjinës në DPD

Sokol Muca – Drejtor në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Pasurive Kulturore

Donald Baze – Përgjegjës në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Pasurive

Megi Qilimi – Specialiste në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Pasurive Kulturor

Andi Mahila – Zëvendësministër i Brendshëm

Krenar Muço – Drejtor i Drejtorisë së Migracionit në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në DPPSH

Emirjola Yzeiraj – Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 18 nëntor 2021.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e kalendarit trejavor të punës së komisionit për periudhën 15 nëntor – 3 dhjetor 2021, si dhe programin e punës 15 nëntor – 24 dhjetor 2021, pra deri në fund të këtij sesioni.

Së dyti, kemi projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 99/2021 “Për ratifikimin e vendimit të komitetit të Përbashkët EFTA – Shqipëri nr. 1 i vitit 2021, miratuar më 24.06.2021, për ndryshimin e protokollit B të marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet shteteve të EFTA-s dhe Republikës së Shqipërisë lidhur me përkufizimin e konceptit të “produkteve origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, si dhe ndryshimi i marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës dhe Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Islandës, si pjesë përbërëse e saj”. Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe relator është kolegu Xhafaj.

Së treti, kemi projektligjin “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës lidhur me vendosjen e kufizimeve të importit të kategorive të materialeve arkeologjike dhe etnologjike të Shqipërisë”. Edhe për këtë jemi komision për dhënie mendimi dhe relatore është kolegja Konomi.

Së fundi, kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për ripranimin e personave dhe protokollit zbatues të marrëveshjes”. Jemi komision për dhënie mendimi dhe relator është kolegu Koçi.

Në rregull, kalojmë në miratimin e kalendarit trejavor të punës së komisionit 15 nëntor – 3 dhjetor 2021, si dhe programit të punës 15 nëntor – 24 dhjetor 2021. Kush është dakord? Shikoj që jemi të gjithë dakord.

Faleminderit!

Për diskutimin e projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 99/2021 “Për ratifikimin e vendimit të komitetit të Përbashkët EFTA – Shqipëri nr. 1 i vitit 2021, miratuar më 24.06.2021, për ndryshimin e protokollit B të marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet shteteve të EFTA-s dhe Republikës së Shqipërisë lidhur me përkufizimin e konceptit të “produkteve origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ dhe ndryshimi i marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës

dhe Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Islandës, si pjesë përbërëse e saj”. Për pikën e dytë kemi të ftuar: zonjën Arjana Dyrmishi, drejtoreshë e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Mirë se erdhët! Gjithashtu, kemi të ftuar zonjën Vjosana Neziri, zotën Ilia Bili dhe zonjën Flutura Shehi. Jam e saktë? Mirë se keni ardhur, zotërinj!

Zonja Dyrmishi, fjala për ju.

Arjana Dyrmishi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Projektligji që paraqitet sot për miratim, ka të bëjë me miratimin e marrëveshjes në fushën e bujqësisë me Norvegjinë. Sikurse edhe nga ana e teknikës legislative, dhe u lexua titulli i projektligjit, aktualisht gjatë periudhës 6-mujore të këtij viti kemi pasur një periudhë intensive në kuadër të amendimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë që kemi me Bashkimin Europian, me CEFT-ën dhe me EFTA-n në lidhje me miratimin e rregullave transitore të origjinës, sipas konventës PEM. Zbatimi i këtyre rregullave transitore të origjinës do të bëhet paralelisht me rregullat ekzistuese dhe do të jenë vetë bizneset, të cilat do të zgjedhin se cilat janë rregullat preferenciale ose më të dobishme për to.

Në ligjin që miratoi parlamenti në seancën e fundit të korrikut, në kuadër të marrëveshjes që kemi me EFTA-ën, miratoi vendimin e komitetit të përbashkët, si dhe marrëveshjen në fushën e bujqësisë me Islandën dhe me Zvicrën. Ndërsa në datën 8 korrik nënshkruam me palën Norvegjeze marrëveshjen në fushën bujqësisë. Për këtë arsye ju vjen për miratim amendimi i ligjit të miratuar në korrik, ku është shtuar edhe marrëveshja me bujqësinë, të cilën e kemi nënshtruar në datën 8 korrik.

Aktualisht, në bazë të dhënave të administratës doganore, për eksportin e produkteve bujqësore me Norvegjinë i kemi në nivele modeste dhe nuk kemi eksporte të dukshme. Për këtë arsye e theksova, sepse aplikimi i rregullave alternative të origjinës, nëse do të shikohet e dobishme nga biznesi i të dyja palëve, do të jetë një shans më shumë dhe një potencial më i madh nga bizneset e të dyja vendeve për t’u eksploruar, në mënyrë që të përfitojnë nga rregullat preferenciale që kemi aktualisht në fuqi për marrëveshjen e tregtisë së lirë mes dy vendeve. Pse ne insistojmë për rregullat preferenciale të origjinës, sepse janë rregulla, dhe, së pari, është fakultative nga bizneset nëse është e dobishme për to, më të thjeshta dhe më fleksibile për t’u përdorur. Aktualisht, administrata doganor ka nisur edhe një tur trajnimi dhe ndërgjegjësimi me të gjithë operatorët vendas për t’u njohur me këto rregulla transitore dhe për t’i përdorur ato jo vetëm në eksportet e tyre që kanë me vendet e EFTA-s, por edhe që

kemi edhe me Bashkimin European, i cili ka hyrë në fuqi më 1 shator, dhe me vendet e CEFT-ës.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja drejtoreshë!

Fjalën e ka kolegu Xhafaj.

Etjen Xhafaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Ne jemi sot këtu “Për ratifikimin e vendimit të komunitetit të përbashkët EFTA–Shqipëri nr. 1 i vitit 2021, miratuar më 24.06.2021 nga Shqipëria, por nga Zvicra është miratuar në datën 8 korrik. Marrëveshja lidhet me përkufizimin e konceptit të “produkteve origjinuese”, si dhe me metodat e bashkëpunimit administrativ dhe ndryshimin i marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës dhe Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Islandës, si pjesë përbërëse e saj, duke bërë një sërë shtesash, ku korrigjohet protokollin për të përfshirë rregullat preferenciale të origjinës në ato që kanë qenë marrëveshjet e deritanishme, si aderuese në marrëveshjet e EFTA-ës. Shqipëria ka një detyrim të dytë që të gjitha këto marrëveshjet, të cilat bëhen në bllok, pra Shqipëria e ka në bllok me të gjitha vendet, t’i kalojë dhe t’i ratifikojë në mënyrë individuale me të gjitha shtetet. Kjo bëhet në funksion të përmirësimit të asaj që është kuadri ligjor dhe nënligjor për sa i përket tregtisë së lirë me vendet e ndryshme, me synimin e promovimit e produkteve me origjinë shqiptare, sigurisht, edhe Norvegjia apo vendet tjera kanë një interes të përbashkët këtu. Kjo marrëveshje me Republikën së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë është pjesë përbërëse e marrëveshjes së tregtisë së lirë që Shqipëria ka nënshkruar me shtetet e EFTA-s dhe ndryshimi është miratimi i një vendimi të komitetit të përbashkët EFTA- Shqipëri për ndryshimin e protokollit B, i cili përcakton konceptet në lidhje me përkufizimin e konceptit të produkteve të origjinës për sa u përket produkteve. Dua t’ju ftoj të gjithëve, duke qenë se është një marrëveshje standarde, të cilat kalojnë herë pas here, sa herë ka ndryshime në këto protokolle ndërkombëtare multilaterale të bashkëpunimit, ta votojmë në mënyrë pozitive.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Xhafaj!

A kanë komente dhe pyetje kolegët?

Në rregull.

Ju falënderoj për mirëkuptimin!

Kalojmë në votimin në parim.

Faleminderit!

Miratohet me votat e të gjithëve.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim projektligjin në votimin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit për bashkëpunimin, kolegë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.11.2021, ora 12:10

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës lidhur me vendosjen e kufizimeve të importit të kategorive të materialeve arkeologjike dhe etnologjike të Shqipërisë”. (*Komision dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Tomor Alizoti, Etjen Xhafaj, Blendi Klosi, Petro Koçi, Besion Ajazi, Vangjel Dule, Bardhyl Kollçaku, Kreshnik Çollaku, Tritan Shehu, Hatixhe Konomi, Klodiana Spahiu, Lavdrim Krrashi dhe Shpëtim Idrizi.

Mungojnë:

Alqi Bllako, Grida Duma, Benet Beci, Belind Këlliçi dhe Greta Bardeli.

Të ftuar:

Sokol Muca – Drejtor i Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Pasurive Kulturore

Donald Baze – Përgjegjës i Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Pasurive

Megi Qilimi – Specialiste në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Pasurive Kulturore

Mimi Kodheli – Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës: projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës lidhur me vendosjen e kufizimeve të importit të kategorive të materialeve arkeologjike dhe etnologjike të Shqipërisë”. Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe relatore është kolegia Konomi.

Të ftuar kemi zotërinjtë Sokol Muça, drejtor i Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Pasurive Kulturore, Donald Baze, përgjegjës pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Pasurive dhe Megi Qilimin, specialiste në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Pasurive Kulturore. Faleminderit, zotërinj, për prezencën! Drejtor, fjala për ju. Ju lutem, dy fjalë për projektligjin.

Sokol Muça – Faleminderit për ftesën!

Memorandumi për vendosjen e kufizimeve të importit është nënshkruar në muajin gusht në Uashington midis ndihmëssekretarit të Shtetit për Kulturën *Matthieu Lussenhop* dhe ministres zonjës Margariti. Është rezultat i një pune 3-vjeçare midis palëve, midis Ministrisë së Kulturës dhe institutit që unë drejtoj dhe orientohet drejt luftës kundër trafikut të trashëgimisë sonë kulturore.

Është një marrëveshje e mbështetur në konventën e UNESCO-s të vitit 1970. Tashmë Shqipëria e ka kaluar fazën e tranzicionit dhe ne kemi dalë nga lista e zezë e trafikimit të trashëgimisë kulturore dhe kemi bashkëpunim edhe me doganën, edhe me policinë. Gjithashtu, jemi të orientuar drejt trajnimit të specialistëve dhe sensibilizimit. Kjo marrëveshje, përveç faktit që kufizon importimin në Shtetet e Bashkuara të një sërë kategorish të materialeve arkeologjike dhe etnologjike, gjithashtu, ofron edhe elemente të tjera, siç janë trajnimi kualifikimi dhe përfshirja e Shqipërisë në databaza të tjera më të rëndësishme për sa i përket mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Gjithashtu në të gjitha rastet kur kemi artefakte shqiptare, të cilat kapen në Amerikë për t'i kthyer ato sipas procedurave të njohura. Për ne është një marrëveshje shumë e rëndësishme për ne, sepse hap dritën jeshile për bashkëpunime të mëtejshme me vende të tjera. Ne sot kemi marrëveshje të tilla bashkëpunimi; kemi me policinë e Italiane, kemi me Interpolin dhe me vendet fqinje.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Muça!

Zonja Konomi, fjala për ju.

Hatixhe Konomi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit përfaqësuesve të institutit për prezantimin projektligjit!

Të nderuar kolegë, ashtu siç e dini, Shqipëria është një vend me një trashëgimi kulturore të spikatur, ku ndër fushat më të rëndësishme të kësaj trashëgimie janë arkeologjia

dhe etnologjia. Të gjithë ne jemi të vetëdijshëm që pas viteve '90 Shqipëria, përveç problematikave të tjera, u përball edhe me fenomenin e grabitjes apo edhe të trafikimit të paligjshëm të veprave të artit, të kulturës, të arkeologjisë e të tjera. Mund të themi se që nga ai moment qeveritë ndër vite kanë bërë përpjekje të vazhdueshme dhe kanë marrë një sërë masash për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore, duke forcuar legjislacionin, duke ratifikuar marrëveshje apo konventa ndërkombëtare, ku ndër më të rëndësishmet është ratifikimi i konventës së UNESCO-s të vitit 1970. Projektligji vjen duke u bazuar edhe në këtë konventë, pra në konventën e UNESCO-s. Dua të them se ky memorandum është shumë i rëndësishëm, ashtu siç e shprehu edhe përfaqësuesi i Institutit të Regjistrimit të Pasurisë Kombëtare Arkeologjike. Fokusi i këtij projektligji është forcimi i bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fushën e vendosjes së kufizimeve të importit për kategoritë e materialeve arkeologjike dhe etnologjike të Shqipërisë. Në fakt, dua të ndalem më shumë në nenin 2 të këtij memorandum, sepse është neni që specifikon më saktë se çfarë do të përfitojnë konkretisht të dyja palët që në rastin konkret janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Shqipëria nga ky bashkëpunim. Konkretisht në këtë marrëveshje është monitorimi i qarkullimit civil dhe fizik të pasurive kulturore ndërmjet dy palëve, me qëllim ndalimin dhe parandalimin e importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë së pasurisë kulturore dhe zbatimin e procedurave në lidhje me importin, eksportin dhe transferimin e pronësisë së pasurisë, referuar nenit 9 të konventës së UNESCO-s të vitit 1970; rritja e ndërgjegjësimit për luftën e përbashkët kundër trafikimit të paligjshëm të objekteve kulturore dhe rëndësinë kontributit të përbashkët ndërmjet palëve dhe menaxhimin apo mbrojtjen e nevojshme të trashëgimisë, si dhe krijimi i mundësive për shkëmbimin e përvojave më të mira në këtë fushë, duke bashkëpunuar me institucionet kompetente të të dyja shteteve që janë palë e kësaj marrëveshjeje. Për sa u përket efekteve financiare, kjo marrëveshje nuk ka efekte financiare, është një marrëveshje kuadër, nuk është bazuar në një plan veprimi. Kështu që, për sa më sipër folëm, kolegë, ju ftoj që ta votojmë dhe ta mbështesim këtë projektligj.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegja Konomi!

Kolegë, a keni pyetje?

Zoti Dule, fjala për ju.

Vangjel Dule – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke shprehur vlerësimin për marrëveshjen e prezantuar, do të doja t'ju bëja një pyetje në lidhje me rezultatet që ka pasur deri tani nga implementimi i marrëveshjeve të

ngjashme me vende të tjera në aspektin e riatdhesimit të vlerave kulturore të trashëgimisë, të cilat ishin trafikuar?

Mimi Kodheli – Kolegë, a keni pyetje të tjera? Nuk ka.

Fjala për ju, zoti drejtor.

Sokol Muça – Ne kemi pasur një sërë bashkëpunimesh, të cilat janë edhe në këto momente që flasim. Ne kemi pasur bashkëpunime me Italinë, me Maqedoninë. Janë një sërë artefaktesh, të cilat janë kapur nga policia italiane apo nga policia maqedonase, por edhe nga të tjerë. Janë procedura që zgjasin, së pari, sepse, kur kemi artefakte, të cilat kapen, bllokohen nga policia e atyre vendeve, duhet të vërtetohen që janë shqiptare, sidomos nëse janë të regjistruar në databazën tonë, më pas bëhet procedura. Ajo që, fatkeqësisht, dihet është se ka nga ato artefakte që kanë humbur, për shembull, në vitet '90, ose edhe më parë, të cilat nuk kanë mundësi identifikimi, sidomos fotografi. Më pas kjo është problematika më e madhe në ato raste kur kapen dhe nuk ka fotografi, atëherë zgjerohet pak fusha, sepse ftohen ekspertë të fushave nëse është një objekt etnografik, ftohen etnologët, derisa të arrihet që më pas të mos ketë më *benefit of the doubt* që është shqiptare dhe bëhet procesi i kthimit.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti drejtor!

Nëse nuk ka pyetje të tjera, mendoj ta hedhim në votim.

Kalojmë në votimin e projektligjit në parim.

Faleminderit!

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim projektligjin në votimin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, kolegë!

E vlerësoj bashkëpunimin.

Faleminderit për prezencën!

Ju lutem, mund të largoheni!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.11.2021, ora 12:20

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për ripranimin e personave dhe protokollit zbatues të marrëveshjes”.
(Komision për dhënie mendimi)

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Tomor Alizoti, Etjen Xhafaj, Blendi Klosi, Petro Koçi, Besion Ajazi, Vangjel Dule, Bardhyl Kollçaku, Kreshnik Çollaku, Tritan Shehu, Hatixhe Konomi, Klodiana Spahiu, Lavdrim Krrashi dhe Shpëtim Idrizi.

Mungojnë:

Alqi Bllako, Grida Duma, Benet Beci, Belind Këlliçi dhe Greta Bardeli.

Të ftuar:

Andi Mahila – Zëvendësministër i Brendshëm

Krenar Muço – Drejtori i Drejtorisë së Migracionit në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në DPPSH

Emirjola Yzeiraj – Përgjegjëse e Sektori të Drejtorisë së Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës

Mimi Kodheli – Kalojmë te projektligji i tretë dhe i fundit: projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për ripranimin e personave dhe protokollit zbatues të marrëveshjes”. Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe relator është kolegu Koçi.

Të pranishëm kemi zotin Andi Mahila, zëvendësministër i Brendshëm, zotin Krenar Muço, drejtori i Drejtorisë së Migracionit në Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe zonjën Emirjola Yzeiraj, përgjegjëse e Sektorit të Drejtorisë së Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës. Mirë se erdhët!

Zoti Zëvendësministër, ju lutem, dy fjalë për projektligjin!

Andi Mahila – Faleminderit!

E nderuar zonja kryetare e komisionit,

Të nderuar anëtarë dhe deputetë të Kuvendit,

Të vendosur për të forcuar bashkëpunimin, me qëllim për të luftuar migracionin e paligjshëm në mënyrë efektive, duke dëshiruar të përcaktojmë me anë të kësaj marrëveshjeje dhe mbi bazën e reciprocitetit të procedurave të shpejta dhe të efektshme për identifikimin dhe kthimin e sigurt dhe të rregullt të personave, të cilët nuk përmbushin ose nuk i përmbushin më tej kushtet për të hyrë, për të qëndruar ose për të banuar në territoret e Republikës së Shqipërisë ose të Britanisë së Madhe dhe të Irlandës së Veriut, si dhe për të lehtësuar kalimin transit të këtyre personave në një frymë bashkëpunimi, duke theksuar se kjo marrëveshje nuk paragjykon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Shqipërisë dhe të Britanisë së madhe dhe Irlandës së Veriut, të cilat burojnë nga drejta ndërkombëtare, në veçanti nga Konventa Europiane e 4 nëntorit 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, nga konventa e 28 korrikut 1951 dhe protokollit i janarit nr. 67 për statusin e refugjatëve dhe nga instrumentet ndërkombëtare për ekstradimin, Këshilli i Ministrave ka paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për ripranimin e personave dhe protokollit zbatues të marrëveshjes”. Ky projektakt propozohet të miratohet në përputhje me nenet 10 dhe 23 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Marrëveshja është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave në datën 30.06.2021 dhe është nënshkruar në datën 8 korrik të vitit 2021 nga ministri i Brendshëm, zoti Çuçi, dhe nga ministrja e Brendshme e Britanisë së Madhe, zonja *Priti Patel*, gjatë vizitës së saj së fundit. Bashkëpunimi i deritanishëm në fushën e ripranimit, por jo vetëm, me strukturat homologe të Mbretërisë së

Bashkuar është shumë e mirë, në vlerësimin tonë, i bazuar në marrëveshjet e mëparshme të nënshkruara për këtë qëllim. Nga Sektori i Migracionit në Departamentin e Kufirit dhe të Migracionit në Policinë e Shtetit, në bashkëpunim me zyrën e migracionit në ambasadën britanike në Tiranë, në kuadër të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe sekretarit të Shtetit në Departamentin e Punëve të Brendshme, që operon nëpërmjet agjencisë së kufirit të Mbretërisë së Bashkuar për shkëmbimin e informacionit për qëllime që lidhen me migracionin 2013, është punuar në vazhdimësi dhe është analizuar me vëmendje fenomeni i migracionit të parregullt i shtetasve shqiptarë, të cilët ndodhen në mënyrë të parregullt në Mbretërinë e Bashkuar. Bazuar në konkluzionet e analizave të kryera, por edhe duke marrë në konsideratë zhvillimet ndërkombëtare dhe dinamikat migratore në shkallë globale, u vlerësua i nevojshëm rinovimi i këtij instrumenti juridik në fushën e ripranimeve. Pas daljes së saj nga Bashkimi Europin, qeveria britanike propozoi rishikimin dhe rinovimin e marrëveshjes ekzistuese, që është nënshkruar në vitin 2003, të cilën Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar me ligjin nr. 9350, datë 03.03.2005, dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 19 të marsit të atij viti. Marrëveshja është hartuar në bazë të modelit komunitar, referuar marrëveshjes Shqipëri Komuniteti European për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, nënshkruar në prill të vitit 2005, në frymën e respektimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me legjislacionin kombëtar të të dyja shteteve, pa paragjykuar angazhimet e tyre të mëparshme dhe bazuar në marrëveshje dypalëshe, shumëpalëshe me vendet treta duke respektuar parimet dhe rregullat e shkëmbit të informacionit mbi të dhënat personale. Palët do të zhvillojnë bashkëpunim teknik dhe operacional në fushën e menaxhimit të migracionit të parregullt dhe sigurisë së brendshme. Marrëveshja parashikon, si subjekte të kërkesave për ripranim kategoritë e shtetasve, si më poshtë: shtetasit e palëve kontaktuese, shtetasit e vendeve të treta dhe shtetasit pashtetësi. Protokollin e zbatimit të marrëveshjes parashikon përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe pikat e kalimit kufitar ndërmjet të cilave do të realizohet kthimi, ripranimi. Shkëmbimi i pikave të kontaktit. kushtet për kthimet shoqëruara, kalime transite të shtetasve të vendeve të treta dhe personat pashtetësi. Në rastin e Shqipërisë për realizimin e kthimit është përcaktuar aeroporti “Nënë Tereza”. Gjithashtu, në marrëveshje janë parashikuar rregullat dhe parimet mbi të cilat do të zbatohet bashkëpunimi, rastet e bashkëpunimit sipas kërkesës, por edhe rastet e bashkëpunimit pa kërkesë, si për elementet e mëposhtme: detyrimi i pranimit të shtetasve të palëve, kushtet dhe procedurat, detyrimet e riparimit. Natyrisht, këto janë pika, të cilat janë raportuar te ju, bazuar në relacionin që është dërguar nga ministria jonë në shoqërim të akteve.

Gjatë fazës së negocimit dhe miratimit në parim të marrëveshjes projektakti i është dërguar për mendim Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Komisionerit për Mbrojtjen e të Drejtave Personale dhe Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar. Marrëveshja ngarkon me përgjegjësinë për zbatim çdo nënshkrues të saj dhe secila palë do të mundësojë pajisjet e nevojshme të komunikimit dhe ato teknike, si telefon, faks, kompjuter dhe internet për zyrtarët e saj. Për palën shqiptare shpenzimet për implementimin e kësaj marrëveshjeje dhe të protokollit të saj do të mbulohen me programin për Policinë e Shtetit. Me pak fjalë, ky ishte një prezantim për këtë marrëveshje; nëse ka pyetje, jemi në dispozicion për t'iu përgjigjur.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Kolegu Koçi, fjala për ju.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

I nderuar zoti Zëvendësministër,

Të nderuar të ftuar,

Mbretëria e Bashkuar është një partner i rëndësishëm i Shqipërisë jo vetëm për euroatlantizmin, pra si një partner i rëndësishëm në NATO. Dihet që pa Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar dhe Kanadanë, Europa është vështirë të jetë e sigurt, por, nga ana tjetër, në një bashkëpunim dypalësh Mbretëria e Bashkuar është një partner shumë i rëndësishëm në luftën ndaj krimit të organizuar dhe krimit në përgjithësi, ku migracioni i paligjshëm zë një vend të veçantë.

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për ripranimin e personave dhe protokollit zbatues të marrëveshjes. Ashtu siç e tha në mënyrë ezauruese edhe zëvendësministri, është një marrëveshje që, në fakt, është në fuqi që nga viti 2003, por, për shkak se tashmë Mbretëria e Bashkuar është jashtë Bashkimit Europian, është rinovuar me kërkesë të palës britanike. Është një marrëveshje shumë e rëndësishme që besoj se e bën Shqipërinë sërish një partner të besueshëm në luftën ndaj një fushe krimi, siç është migracioni i paligjshëm. Nga pikëpamja teknike shpjegimet e zëvendësministrit ishin ezauruese. Unë e ftoj të gjithë komisionin që ta aprovojë në mënyrë konsensuale këtë projektligj. Ne jemi një komision vetëm për dhënie mendimi, por, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar, jemi një komision shumë domethënës dhe besoj se konsensualiteti do të ishte një mesazh shumë i qartë për Kuvendin.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Koçi!

Fjalën e ka kolegu Çollaku, më pas kolegët Shehu dhe Krrashi.

Unë kam një pyetje. Sa reciprocitet ka në këtë marrëveshje? Pra, nëse ndodh e kundërta, sepse përcaktohet aeroporti “Nënë Tereza”, mund të ndodhë, se ne jetojmë në një botë globale intriguese. Kjo ishte pyetja.

Ka pyetje zoti Shehu, më pas kanë komente kolegu Çollaku dhe kolegu Krrashi.

Tritan Shehu – Faleminderit!

Si ndryshon kjo marrëveshje nga marrëveshjet komunitare? Ku janë pikat e ndryshimit, realisht kur flitet për personat me origjinë nga vendet e treta?

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Shehu!

Zoti Zëvendësministër, fjala për ju për përgjigjet, më pas kolegu Çollaku dhe kolegu Krrashi.

Andi Mahila – Në lidhje me pyetjen tuaj, zonja kryetare, përgjigjja është: reciprocitet absolut. Më duhet të them se kjo marrëveshje është një marrëveshje model jo vetëm për rastin, por për çdo rast të administratës sonë. Natyrisht, ne e kemi pjesë të punës dhe e kemi konspektuar në gërmë; nuk lë absolutisht asnjë presje të paparashikuar në mënyrën më koncize të mundshme dhe në mënyrën më profesionale të mundshme për diskutime, që ndodh shpesh në administratë, dhe për interpretime. Në qoftë se lexohet, kjo është marrëveshje model dhe nuk lë fare vend për interpretim, por zbatohet. Për sa i takon reciprocitetit, është absolut. Në të dyja rastet nuk ka asnjë vend për diskutim, qofshin për shtetasit tanë që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në Britani, qofshin për shtetasit Britanik që qëndrojnë këtu, qofshin për shtetasit me leje qëndrimi të vendeve reciproke, qofshin për shtetasit me shtetësi joshqiptare dhe jobritanike, pra të vendeve të treta, të cilët...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë doja të thosha.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në përgjigjen që dhashë për pjesën e reciprocitetit, përfshihet edhe ky element. Për Republikën e Shqipërisë është e përcaktuar konkretisht aeroporti “Nënë Tereza”, për Mbretërinë e Bashkuar janë përcaktuar në protokollin zbatues të kësaj marrëveshjeje. Është nga marrëveshjet model që nuk ka vetëm marrëveshje, por shoqërohet me një protokoll, i cili e detajon akoma më tepër marrëveshjen dhe janë përcaktuar të gjitha aeroportet e Mbretërisë së Bashkuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për sa i përket pyetjes se çfarë ndryshimi ka kjo marrëveshje me marrëveshjen kuadër të BE-së, e thashë edhe pak më parë gjatë fjalës sime që kjo marrëveshje ka si referencë modelin e marrëveshjes me BE-në. Ne që nga viti 2003 kemi një marrëveshje me Britaninë e Madhe që u tha. Në fakt, kjo me zhvillimet që kanë ndodhur nuk ndryshon, thjesht pasuron me elemente, të cilat kanë dalë nga analizat e bashkëpunimit, që kemi pasur deri tani, të strukturave tona; është bërë një proces analitik, i cili ka dalë në disa konkluzione, me detaje teknike operacionale, të cilat kjo marrëveshje dhe protokollin e saj i zbatimit i sjell dhe i përditëson.

Në princip me marrëveshjen komunitare kuadër është e njëjta gjë, janë të njëjtat parime, janë të njëjtit principe. Mund të them se kjo marrëveshje detajon akoma në mënyrë teknike, jo se marrëveshja komunitare nuk i ka të përfshira përcaktimet e bashkëpunimit, por kjo i ka akoma më të detajuara, për shkak se ka edhe protokollin e zbatimit bashkëlidhur. Marrëveshja kuadër me BE-në, nga ana tjetër, e lë të mundur në nenin 15 të saj që vendet në marrëdhëniet e tyre bilaterale mund të nënshkruajnë protokolle zbatimi, ndërsa kjo marrëveshje e ka protokollin e zbatimit pjesë integrale të saj, pra edhe protokollin është pjesë e marrëveshjes.

Për sa u përket vendeve të treta, ruhet reciprociteti për shtetasit e vendeve të treta, por nuk kemi vetëm ata që janë në Shqipëri apo ata që janë në Mbretërinë e Bashkuar, bëhet fjalë dhe për ata të cilët për një arsye të caktuar do të kalojnë transit nga Britania e Madhe nëpërmjet Shqipërisë për në vendin e origjinës apo edhe anasjelltas. Edhe ky element i transitit është i përfshirë dhe i detajuar. Prandaj, thashë se është model marrëveshje.

Mimi Kodheli – Zoti Çollaku

Kreshnik Çollaku – Faleminderit!

Në fakt, edhe unë, personalisht, i bashkohem kërkesës që bëri zoti Koçi. Kjo lloj marrëveshje, në gjykimin tim, meriton të ketë një mbështetje konsensuale. Personalisht e mbështes, është një vijimësi marrëdhëniesh dhe angazhimesh të Shqipërisë me partnerët tanë, dhe një ndër partnerët më të rëndësishëm, është Mbretëria e Bashkuar, edhe në kuadrin e partneriteteve të tjera, pra deklaroj se e mbështes pa asnjë lloj hezitimi marrëveshjen. Komentin nuk doja ta bëja në lidhje me marrëveshjen konkrete, por dua të shfrytëzoj këtë moment për të lidhur një çështje, e cila prej kohësh më shqetëson, dhe besoj se nuk jam i vetmi. Këtu flasim për trajtimin e një plaje që ka lidhje me aktivitete të emigracionit të paligjshëm, dhe ky është një fenomen global, sidomos i një vendi dhe një kombi, si Shqipëria, ku ju sfidoj të kërkonit në raport me popullsinë e banorëve, që jetojnë

në territor dhe banorëve që jetojnë jashtë territorit, ne mund të jemi ndër vendet unike në botë, ku thuhet se gjysma popullatës jeton jashtë kufijve. Praktikisht, jashtë kufijve ne kemi një Shqipëri tjetër; gati-gati më vjen zor që këtë e diskutojmë si çështje të politikës së jashtme; emigracioni dhe diaspora nuk janë për Shqipërinë çështje të politikës së jashtme; ka edhe një nënkomision, më duket, të diasporës. Emigracioni dhe diaspora duhet të jenë çështje e shtetit shqiptar, sepse gjysma e popullatës jeton jashtë kufijve dhe ne mbledhemi e diskutojmë për këta njerëz vetëm për raste apo detyrime të tilla, për ripranime, për situata ekstreme të përjetimit të tyre, por ne harrojmë që atje jeton gjysma e popullatës sonë dhe ne nuk kujtohem se ata ekzistojnë, përveçse në raste të tilla.

Zonja kryetare, unë e thashë edhe në seancë, edhe në raport kaluat buxhetin para pak ditës, ka zero politika shtetërore për emigracionin dhe diasporën tonë; rutinë. Është e pamundur që qeveria e Kosovës të mbështesë Shqiptarët e Luginës së Preshevës me 500 mijë euro asistencë, libra, arsim e të tjera dhe Tirana të japë 5 mijë. Po, a është e drejtë kjo histori? Nuk po u them të krahasojmë politikat shtetërore që ndjek shteti shqiptar me vende lidere apo me komunitete shumë të zhvilluara, me Izraelin, me Turqinë apo me vende të tjera, që janë pjesë e zhvillimit të shtetit, por edhe me vende të Ballkanit. Futuni e studioni dhe shikoni se çfarë bëjnë shtete të tjera me mundësi ekonomike e financiare shumë më të vogla se Shqipëria, janë shumë aktive në raport me diasporën me politikat që ato zhvillojnë, që të mos ngelemi ta trajtojmë emigracionin vetëm kur ka raste të tilla ekstreme, të cilat janë fenomene jashtëzakonisht negative. Po çfarë bëjmë ne me të drejtat e tyre atje ku jetojnë? Këtu folëm për reciprocitet dhe situata ekstreme, po për çfarë bën shteti shqiptar për t'i mbrojtur të drejtat e këtyre njerëzve? Çfarë bëjmë ne, kur shqiptarëve u grisen pasaportat dhe ua plasnin turinjve? Çfarë bëjmë ne kur fëmijët atje rriten dhe po humbasin gjuhën shqipe? Çfarë bëjmë ne?! Disa abetare që dërgojmë, nuk e zgjidhin. Çfarë bëjmë ne për të gjithë atë kapital të madh investimesh që diaspora prodhon dhe shpërndahet, ose vijnë si remitanca këtu, por nuk ka asnjë orientim strategjik për ta thithur këtë fuqi të madhe ekonomike? Çfarë bëjmë ne? Çfarë bën shteti shqiptar? Çfarë bën ky parlament? Më besoni, unë jam koshient që kjo nuk zgjidhet nga një veprim, një vendim, një akt apo një sjelljeje, por duhet të fillojmë të ndryshojmë qasjen në trajtimin e këtyre njerëzve, se është gjysma e Shqipërisë që jeton atje dhe ne nuk mund t'i trajtojmë më si fenomene në raste të ngjashme apo t'i takojmë kur vijnë një herë për turizëm. Shteti shqiptar duhet të fillojë të ketë politika aktive, energjike për të mbështetur, për të nxitur dhe për të stimuluar fuqinë e diasporës sonë nëpër botë. Kjo bëhet vetëm duke krijuar këto kanale, duke mbrojtur të drejtat e tyre, duke orientuar investimet e tyre, duke asistuar

ruajtjen e identitetit tonë, të gjuhës dhe traditat e të gjitha atyre komuniteteve; është e pamundur të vazhdohet. Jemi në vitin 2021 dhe emigracioni trajtohet ende si në vitet '90. Jemi vendi i fundit në Ballkan që ka këtë qasje pasive karshi diasporës dhe migracionit tonë dhe do ta shikoni se, duke e mbështetur diasporën, emigracionin tonë në botë, edhe shteti shqiptar do ta ketë zërin më të fortë në çdo institucion, sepse ata janë njerëz që punojnë, kontribuojnë edhe në vendin tonë, por ata janë njerëz kontribuues dhe votues edhe në vendet ku jetojnë dhe është forcë. Popuj të tjerë, shtete të tjera, institucione të tjera shtetërore të kombeve të tjera kanë ditur ta përdorin këtë fuqi që kanë. Është koha që ne të zgjohemi, parlamenti shqiptar nuk mund t'i trajtojë emigracionin, diasporën si nënsektorë të politikës së jashtme. Diaspora dhe migracioni duhej të ishin çështje e shtetit shqiptar, e parlamentit shqiptar e çdo segmenti të jetës sonë. Si mund të katandisemi e të flasim për ata njerëz vetëm në raste të tilla? Është një apel, është një koment, por është një shqetësim, por më besoni që këtu ka njerëz që kanë kontakte, që kanë jetuar jashtë, realisht gjendja është keq, kur shkona atje dhe dëgjon raste të tilla pafund. Si mund të heshtë shteti shqiptar, kur një emigrantit tonë me të drejtë dhe pa të drejtë i grisët dhe i hidhet pasaporta fytyrës? Ka pafund raste të tilla. Fëmijët nuk flasin gjuhën; kapitalët që ata bëjnë, nuk kanë një mundësi investimi; nuk ndiejnë praninë e shtetit dhe të institucioneve të vendit. Shteti nuk është vetëm një konsullatë që certifikon një certifikatë vdekjeje apo udhëtimi apo rastet kur kapen dhe duhet të transportojnë. Nuk është shteti vetëm kaq. Sidomos në një vend si ne që gjysmën e Shqipërisë e kemi jashtë kufijve, në mënyrë radikale duhet të rikonceptohet qasja e institucioneve të shtetit shqiptar, e qeverisë shqiptare karshi këtyre njerëzve, që janë gjysma e kombit.

Faleminderit!

Patjetër konfirmoj mbështetjen me votë për çështjen dhe shpresoj që kjo të dëgjohet, sepse është një çështje shumë e ndjeshme. Sapo të kaloni apo kur të kaloni dhe kur t'i takoni njerëzit atje, kudo nga cili burim, nga cili kontingjent, nga cili nivel kulturor, pune apo niveli kjo është problematika që ata kanë. Në rast se ne nuk zgjohemi, realisht krijojmë një hendek shumë të madh që të humburit e mëdhenj do të jemi.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Çollaku!

Personalisht, e vlerësoj sensibilizimin tuaj, në raport me kolegët tjerë, por edhe në raport me kush dëgjon.

Kolegu Krrashi fjala për ju.

Lavdrim Krrashi – Faleminderit, për prezantimin!

Patjetër që marrëveshja duhet të ratifikohet; është krejt normale që qytetarët, që jetojnë në një vend tjetër në mënyrë të paligjshme, qoftë duke e kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme për herë të parë apo ata, të cilët u janë drejtuar autoriteteve britanike duke bërë kërkesa për azil, në bazë të konventës të refugjatëve, që iu referuat, dhe protokollit të vitit 1951 dhe kur humbin të drejtën për të qëndruar në Britaninë e Madhe, duhet të riatdhesohen. Në Britaninë e Madhe pjesa më e madhe e qytetarëve shqiptarë që jetojnë, nuk janë në kategorinë e dytë, që sapo e shpjegova, por janë krejt të ligjshëm, janë kontribuues në shoqërinë britanike, në fakt, kontribuues shumë të mëdhenj. Për fatin tonë të keq, media kryesisht, por edhe të tjerët, bëjmë lajmet e këqija. Lajmi i keq udhëton shumë shpjet, lajmi i mirë do shumë punë për të udhëtuar.

Dua të bëj një sugjerim: të përfitojmë nga rasti, sepse Britania e Madhe, ose Mbretëria e Bashkuar për të qenë korrekt, është larguar nga Bashkimi Eruopian, por jo nga Europa. Si e tillë, ajo është në kohën e vet, sepse, para se të bëhej referendumi i famshëm i *Brexit*, dhe kanë kaluar 5 vjet, mendohej ose parashikohej se çfarë mund të ndodhë me *Brexit*, sot ata po vuajnë pasojat e *Brexit*. Një nga pasojat e *Brexit*, që për ne është fatmirësi, është se ka shumë vende pune në tregun britanik. Ju duhet t'i keni parë lajmet se para 2 muajsh kishte një krizë për shoferët e maunave që shpërndajnë naftën apo gazin nëpër pikat e karburanteve. Si ajo fushë, ka edhe fusha të tjera; ka një hapësirë prej 1,7 milionë njerëzish që duhen për të punuar. Britania ka nevojë për punonjës. Ne mendoj se duhet ta shfrytëzojmë, pra përveç kësaj, patjetër duhet ta nënshkruajmë dhe duhet ta ratifikojmë, që të kërkojmë prej Britanisë së Madhe edhe bashkëpunim, për arsye se, në qoftë se ne kërkojmë një marrëveshje, dua të sugjerojmë të shkojmë me shifra shumë të mëdha, 100 mijë. Pse them 100 mijë? Sepse kaq mendoj se është numri i shqiptarëve në Britaninë e Madhe. Pra, qytetarëve shqiptarë t'u jepet e drejta për të punuar në Britaninë e Bashkuar ligjërisht, se të gjithë e dimë, kur ligj thotë nuk lejohet për të hyrë diku, njerëzit kërkojnë për ta thyer ligjin. Pra, të përdorim fuqinë e faktit që Britania është larguar nga BE-ja, por jo nga Europa, dhe faktin që ka nevojë për punësime dhe ka punëtorë tepër të kualifikuar që mund të shkojnë nga Shqipëria në Britaninë e Madhe, por të kthehen. Jam shumë dakord me kolegun Çollaku që askush nuk gëzohet kur pasaporta e një qytetari shqiptar... Në fakt, kjo nuk ka ndodhur ndonjëherë me Britaninë e Madhe, por kudo që të ndodhë në ndonjë vend tjetër, kërkohet që të respektohet ai dokument.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Nuk mendoj se ndodh në Britaninë e Madhe, më beso, kam jetuar 26 vjet atje. Gjithsesi, të shfrytëzojmë momentin për të krijuar mundësitë që qytetarët shqiptarë të shkojnë të punojnë në mënyrë të rregullt në Britaninë e madhe.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Krrashi!

Besoj se nuk ka më pyetje dhe komente, kështu që më lejoni ta hedh në votim ratifikimin e marrëveshjes.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me të gjitha votat.

E hedhim projektligjin në votimin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, zoti Zëvendësministër, për prezencën!

Faleminderit, kolegë!

Punë të mbarë! Nuk kemi mbledhje tjetër.

Mbyllim mbledhjen e komisionit!

MBYLLET MBLEDHJA

